



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.233/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afiete Sada-Gllogjani anëtare, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Larët Ligjore, Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si të pabazuar ankesa e parashtruar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, ZL.Anr. 233/2017 e datës 17.10.2017 me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet.

A r s y e t i m

Me datën 17.10.2017, PZAP-i ka përmes postës ka pranuar një ankesë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prizren, me të cilën pretendon se me datë 07.10.2017, komisioner dhe vëzhgues nga lista për certifikim e AAK-së kanë pranuar SMS me ftesë për një tubim nga ana e LVV-së, kjo ftesë kishte përmbajtje “Nesër më 8 tetor, në ora 15:00 tek Pallati i Kulturës “Xhemail Berisha” do të mbahet takim me komisioner dhe vëzhgues, pjesëmarrja është obligative”, dhe kjo ftesë ka shkaktuar huti tek komisionerët dhe Vëzhguesit e AAK-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, nga ana e subjektit politike LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika d) dhe g) të LZP-së, ngase përmbajtja e SMS-së

siç potencon vetë parashtruesi i ankesës ka të bëjë me informim e mbajtjes së një tubimi të caktuar që nuk ndërlidhet me shkeljen e Kodit të Mirësjelljes.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.233/2017 më datën 18.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenin 118.4 të LZP-së.*

